

Në zbatim të Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërit nr. 60 datë 5.4.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor” i ndryshuar, ASIG shpall konkurimin për vënd të lirë pune në pozicionin :

- Punonjës për magazinën, Sektori i Financës

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe punës në grup.

Paga për pozicionin magazinier: është në kategorinë me klasa – VI.

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 23/06/2016 në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në adresën: Godina e Inovacionit, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati II, Tiranë, ose në adresën e e-mailit Info@asig.gov.al, këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
- CV;
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Raport mjeko-ligjor;
- Të paktën një letër rekomandimi nga punëdhënës të mëparshëm;
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar.

(Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

Pas verifikimit paraprak të aplikimeve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor do të njoftohen konkurrentët e kualifikuar, si dhe data kur do të zhvillohet intervista.